

VENDIM
Nr. 201, datë 15.3.2017

**PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË POLICISË
SË BURGJEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, shkronja “b”, 4, shkronja “d” dhe 5, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 10 032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve janë sipas lidhjes nr. 1, “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga bazë mujore për gradë (kolona 3), e lidhjes nr. 1, është niveli i pagës së punonjësit në përputhje me gradën që ka fituar brenda rolit përkatës.

3. Shtesa për natyrë të veçantë pune dhe shërbimi (kolonat 4, 5 dhe 6) të lidhjes nr. 1, jepet sipas funksioneve/pozicioneve të përcaktuara në këtë lidhje.

4. Punonjësi i Policisë së Burgjeve me grada, për kohën e qëndrimit në gradë, përfiton shtesë për vjetërsi në punë, në masën 1 për qind, pas çdo viti pune. Masa e shtesës për vjetërsi në punë të jetë deri në nivelin e pagës bazë të gradës pasardhëse. Përlllogaritja e shtesës për vjetërsi në punë të fillojë në çastin e marrjes së gradës së re, sipas ligjit nr. 10032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”.

5. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vitet e qëndrimit në gradë, të dokumentuara në librezën e punës së çdo punonjësi në strukturat e Policisë së Burgjeve, si dhe në strukturat e Policisë së Shtetit, Gardën e Republikës, Forcat e Armatosura dhe Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë, sipas ekuivalentimit në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

6. Vitet që përjashtohen nga llogaritja e shtesës së vjetërsisë në punë, vetëm për efekt pagese, janë vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, vitet e punës si punonjës pa grada, vitet e shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit ushtarak të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe periudhat e trajtimit me pagesë papunësie apo pagesë kalimtare.

7. Vendimi nr. 1061, datë 18.7.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të Policisë së Burgjeve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

8. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e miratuara në ligjin nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, për politikat e reja të pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LIDHJA NR. 1
STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BURGJEVE

Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi		
1	2	3	4	5	6
			Në funksion të policisë së regjimeve të jashtme, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale	Në funksion të policisë së regjimeve të brendshme dhe transferim-shoqërimet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale	Në funksion të policisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve
Bazë	Nëninspektor	40.200	4.000	8.000	
	Inspektor	43.900	4.000	8.000	
	Kryeinspektor	49.300	4.000	8.000	2.000
I mesëm	Nënkomisar	60.000	4.000	8.000	2.000
	Komisar	65.000	4.000	8.000	2.000
	Kryekomisar	89.000	4.000	8.000	2.000
I lartë	Drejtues	101.700			6.500
	Drejtues I	106.000			15.000
Drejtor i Policisë së Burgjeve	Drejtor i Policisë së Burgjeve	110.000			

